UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

FAKULTETI I EDUKIMIT

DEPARTAMENTI I LETËRSISË

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Arsimi dhe Lidershipi

Strategjitë e mësimdhënies në mbështetje të nxënësve me aftësi ndryshe

Studim mbi strategjitë që duhen ndërmarrë në nivel shkolle kundrejt nxënësve me aftësi ndryshe

Punoi: Anxhela Noka

Master Profesional në Mësimdhënie për Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, Viti I

Durrës, 2021

I. Hyrje

Të shkollohesh është një e drejtë themelore njerëzore por ajo çfarë duhet të themi është fakti se sot, shumë fëmijë privohen nga e drejta e arsimimit. Shkollimi duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë nxënësit pa dallim (Musai, 1999). Një ndër grupet kryesore që ende nuk kanë akses në arsimim janë nxënësit me aftësi ndryshe ndaj, ky punim do të fokusohet në prezantimin, sqarimin dhe shpjegimin e hollësishëm të të gjitha hapave dhe strategjive, të cilat duhen ndërmarrë në nivel shkolle për përfshirjen në mjediset shkollore të fëmijëve me aftësi të veçanta.

Një vëmendje të rëndësishme në këtë studim do t'iu kushtojmë paraqitjes së metodatve dhe strategjive më efektive në mësimëdhënie dhe mësimnxënie për këtë kategori nxënësish. Ajo çfarë duhet të themi është se për të arritur një mësimdhënie sa më efektive për nxënësit me aftësi ndryshe duhet të kemi një bashkëpunim të vazhdueshëm mësues – nxënës. Në këtë studim do të trajtohen edhe faktorët kryesor të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë që nxënësit me aftësi ndryshe të mos ndjekin shkollat publike.

Nëpërmjet këtij studimi do të realizohen disa objektiva të cilat janë:

- Përcaktimi i strategjive dhe metodave që duhet të zhvillojë shkolla në mbështetje të nxënësve me aftësi ndryshe.
- Identifikimi i faktorëve që nxisin mungesën e pjesmarrjes së nxënësve me aftësi ndryshe, në shkollat normale, publike.
- Roli i mësuesit në integrimin dhe në socializimin e nxënësve në ambientet shkollore.
- Studimi rreth shifrave të nxënësve në shkollat publike që janë pjesë e shërbimeve të arsimit të veçantë.

II. Rishikimi i Literaturës

II.1. Strategjitë që duhen ndërmarrë në nivel shkolle kundrejt nxënësve me aftësi ndryshe

Kjo pjesë e parë e punimit do të fokusohet në prezantimin dhe shpjegimin e hollësishëm të strategjive, politikave dhe praktikave që duhet të zhvillojë shkolla, për lehtësimin e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në jetën e shkollës. Më konkretisht përfshihet një informacion i nevojshëm sesi shkolla të përfshijë në planin dhe dokumentat e saj bazë, procedura për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara duke filluar nga momenti i regjistrimit të fëmijës në shkollë e deri në përshtatjen e plotë të tij në shkollë.

Për të arritur një mësimdhënie cilësore për këtë grup nxënësh në sistemin arsimor shqipëtar së pari shkollat e vendit tonë duhet përmirësojnë faktin e të qenurit shkolla të hapura ndaj nxënësve me aftësi të ndryshe. Shkolla duhet të ketë gjithmonë qëlim të vetin të inkurajojë të nxënit e njohurive teknike ose "teknikat" në lidhje me kushtet e lirisë, të kultivojë njohuri të natyres njerëzore ose vetënjohuritë të cilat lejojnë një kuptim të plotë, ose domethënien e jetës, për të jetuar një jetë të integruar (Haxhihyseni & Muho, 2017). Në thelb, një shkollë e hapura ndaj nxënësve me aftësi të ndryshe zbaton për to drejtën për për arsim cilësor. Shkollat tona duhet të arrijnë një stad të lart zhvillimi ku diversiteti mes nxënësve të mirëpritet dhe i gjithë stafi të përgatitet në marrjen e masave të nevojshme që nxënësit të ndihen mirë (Bennet & Dworet & Weber, 2008).

Integrimi dhe përfshirja e personave me aftësi ndryshe në mjediset shkollore mbetet një përgjegjësi kryesore e shkollave tona, një përgjegjësi e cila ende sot nuk është marrë për bazë pasi akoma vihet re dukshëm një mosrespektim i të drejtës që kanë këto nxënës për tu arsimuar në mënyrë cilësore. Janë shumë probleme shqetësuese të cilat kanë një ndikim të madh që një pjesë e mirë e kësaj kategorie nxënësish, të mos ndjekin shkollat normale.

Krijimi i aksesit për fëmijët me aftësi ndryshe ka qenë dhe mbetet një problem shqetësues në vendin tonë (Bennet & Dworet & Weber, 2008). Shkollat këshillohen të vendosin në rregulloret e tyre masa/procedura për lehtësimin dhe monitorimin e kujdesshëm të ditëve dhe javëve të para të fëmijës me aftësi të kufizuar. Strategjitë dhe masat që duhet të propozojë shkolla me qëllim që fëmija të jetë pjesëmarrës aktiv, të inkurajohet dhe të ndjekë rregullisht shkollën, duhet të bazohen në praktikat më të mira në legjislacion (Miller, 2003).

Në shkollat e vendit tonë janë disa tregues që bëjnë me dije se kjo kategori nxënësish po has vështërsi me përshtatjen në shkollë, një nga këto tregues është pjesëmarrja jo e mirë në ditët e javëve të para. Për të shmangur pakënaqësi dhe për t'iu ardhur në ndihmë nxënësve shkollat duhet të marrin në konsideratë:

• Së pari, hartimin e një plani të hershëm ndërhyrjeje për lehtësuar proçesin e përshtatjes së fëmijës në shkollë,

• Së dyti, duhet të merren masa për të parandaluar që herët cënimin fizik, psikologjik dhe emocional të fëmijës.

II.1.2 Planifikimi dhe organizimi i shkollës për gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të veçantë

Është shumë e rëndësishme që shkolla të marrë të gjitha masat e nevojshme që çdo cënim i fëmijëve me aftësi të kufizuara të ndëshkohet nga komisioni i disiplinës në shkollë, me qëllim që të parandalohet përsëritja e tyre (Musai, 1999). Dështimi i shkollës në marrjen e masave parandaluese, duke përfshirë këtu rishikimin e planit dhe rregullores së brendshme, mund të çojë jo vetëm në dështim të përfshirjes së nxënësve por edhe në një vlersim negativ për shkollën.

Për të krijuar një mjedis të përshtatshëm mësimor duhet marrë në konsideratë edhe këndvështrimi që prindër të ndryshëm mund të mbajnë në situata të caktuara prandaj, shkëmbimi i informacionit me ta dhe mënyra e përfshirjes së tyre duhen parë si mjetet kryesore për të arritur një mësimdhënie të kënaqshme për nxënësit me aftësi ndryshe. Gjatë kohës që është fëmija në shkollë duhet që rrugët e komunikimit prind- mësues dhe mësues – fëmijë të jenë të hapura dhe të mbajtura mire (Bojaxhi, 2000). Shkolla duhet të zhvillojë procedura të ndryshme, përmes të cilave të sigurojë se prindërit ndjehen të mirëpritur e të mirëinformuar në shkollë, në intervale të rregullta kohore, për përparimin e fëmijëve të tyre (Bennet & Dworet & Weber, 2008).

Roli i prindërve është thelbësor në përshtatjen e nxënësve në ditët e para të shkollës prandaj, në shkollat tona duhet të zhvillohen praktikat e nevojshme për përfshirjen dhe rolin e prindërit gjatë proçesit të përshtatjes së fëmijës në shkollë. Një strategji kryesore që duhet të ndjekin shkollat është zbatimi i një plani ndërhyrje për mbështetjen e nxënësve me vështirësi të ndryshme(Emmer & Evertson, 2018). Bazuar në modelet e specializuara ndërkombëtar mësipër sugjeruam disa nga procedurat që duhet të ndjekin të gjitha shkollat e vendit tonë për mbështetjen e hershme të nxënësve dhe për t'iu plotësuar atyre të drejtën që kanë për arsim cilësor.

II.1.3 Roli i mesuesit ne integrimin dhe socializimin e nxenesve

Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm mësimdhënës për nxënësit me aftësi ndryshe është një përgjegjësi e bordit drejtues, e veçanërisht e mësuesit. Mësuesi duhet të zotërojë dhe të përdorë një larmi teknikash komunikimi efikas për të zhvilluar bashkëpunimin dhe ndërveprimin mbështetës në klasë (Zekaj, 2018). Rruga më e mirë që duhet të ndjekin mësuesit në krijimin e një klime sa më të përshtatshëme për të nxënë është ajo nëpërmjet motivimit dhe vlerësimit.

Nxënësit me aftësi ndryshe shfaqin vështirësi të mëdha në të nxënë, shpesh herë ata kanë një motivim të ulët dhe shprehen me zemërim e sjellje të shumta sfiduese. Për ti parandaluar këto sjellje agresive, për të patur një marrëdhënie të kënaqshëme mësues – nxënës, mësuesi duhet të jetë i aftë të ndërtojë një klimë pozitive (Emmer & Evertson, 2018). Kjo klimë pozitive për të nxënë arrihet atëherë kur nxënësit shohin se përpjekjet që ato bëjnë vlerësohen nga pala tjetër.

Duhet të bëjmë me dije se një klimë pozitive ashtu si në institucionet arsimore të specializuara ndërkombëtare do të arrihet në shkollat tona atëherë kur:

- Mësuesi të ketë një strategji të qartë për të menaxhuar klasën që ka në udhëheqje
- Nxënësit trajtohen me respekt, duke i'u dhënë e njëjta mundësi përfshirjeje në proçesin mësimor.
- Kur mësuesi është gjithmonë duke i inkurajuar nxënësit për të arritur standarte të larta sjellje etj.

Për të krijuar një mjedis të përshtatshëm në të nxënë nxënësve me aftësi ndryshe duhet t'iu mundësohet paisja me materiale konkrete dhe praktike ku përfshihen mjete të avancuara teknologjike. Nxënësit duhet të ndihen të lirë. Liria dhe autonomia janë qëllimet finale të edukimit që synojnë formimin e personalitetit të lirë dhe autonom (Haxhihyseni & Muho, 2017). Për të nxitur zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore duhet t'iu mundësohet organizimi i aktiviteteve të ndryshme në të cilat nxënësit do të praktikojnë dhe do të luajnë me role aftësitë personale dhe shoqërore të mësuara në situata të ndryshme. Për plotësimin dhe prezantimin e detyrave të klasës apo të shtëpisë atyre duhet t'iu jepet koha e mjaftueshme dhe mundësia për të bërë një prezantim të detyrës në mënyra të tjera alternative. Për t'iu ardhur më tepër në ndihmë, nxënësit me aftësi të veçantë duhet të kenë akses në tekste të pangarkuara.

II.1.3 Udhëzime për një mësues që mëson nxënës me nevoja të veçanta

Në këtë pjesë të studimit kemi paraqitur informacion kryesisht, për mësuesit se çfarë duhet të kenë në konsideratë në mësimdhënien për fëmijët me aftësi të ndryshe. Në të jepen udhëzime të hollësishme, sesi mësuesi duhet të përshtasë mjedisin e klasës duke mundësuar përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar gjatë zhvillimit të proçesit mësimor. Suksesi i shkollës në ofrimin e arsimimit për nxënësit me aftësi të kufizuara varet shumë edhe nga ndryshimet që bëhen në të gjithë shkollën, si dhe strategjive dhe metodave të ndryshme mësimore që zbatojnë mësuesit në klasat e tyre (Jackson, Shirley &Lunenburg). Një mjedis klase i përshtatshëm për këta nxënës karakterizohet nga struktura dhe organizimi, ka pajisjet dhe materialet e nevojshme dhe lejon akses të mirë të nxënësit. Mësuesi duhet të krijojë një mjedis të përshtatshëm në klasë ku të gjithë nxënësit të respektohen, motivohen dhe mbështeten për t'u arritur rezultatet e pritshme. Disa nga detyrat që kërkohen nga mësuesit janë: të respektojë arritjen e rezultateve të pritshme, të krijojë mjedisin e përshtatshëm në klasëe dhe të respektojë, të motivojë dhe të mbështesë të gjithë nxënësit (Zekaj, 2018).

Nxënësit me aftësi ndryshe siç e dimë kanë karakteristika të ndryshme personale në sjellje, interesa e qëndrimin ndaj mësimit, sikurse dhe çdo grup tjetër i nxënësve në shkollë. Udhëzimet dhe metodat në mësimdhënie për këta fëmijë duhet planifikuar me kujdes, menaxhuar dhe vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme. Mesuesit duhet të përfshijnë në kursin e tyre aktivitete të mësimdhënies qe do ti ndihmojë nxënësit të ndërtojnë fjalorët e tyre (Emmer & Evertson, 2018). Pra, nxënësve me aftësi ndryshe i'u duhen dhënë mundësi të marrin pjesë dhe të shijojnë aktivitetet në klasë dhe jashtë saj.

II.4 Studim rreth shifrave të nxënësve në shkollat publike që janë pjesë e shërbimeve të arsimit të veçantë

Të gjithë nxënësit e diagnostifikuar si nxënës me nevoja të veçanta kanë të drejtë të arsimohen në institucionet arsimore publike, në mjedisin ku ato jetojnë. Shkolla si institucion e fut fëmijën në një grup moshor, funksionet e saj janë: arsimimi, socializimi, formimi i shkathtësive dhe shprehive, seleksionimi për pozitën e mëvonshme sociale dhe paisja me diplomë (Haxhihyseni & Muho, 2017). Një dokument shumë i njohur në të cilin është bërë një klasifikim rreth nxënësve me nevoja të veçanta të cilët janë identifikuar si të përshtatshëm për të gëzuar shërbimet e arsimit të veçantë është dokumenti i titulluar "Përmbledhja e statistikave të arsimit".

Në krahasim me institucionet arsimore të Europës në shkollat tona shumë fëmijë të kategorive të mësipërme nuk kanë akses në arsimim. Rëndom, ndodh përjashtimi i tyre nga e drejta që ato gëzojnë për arsimim cilësor dhe të barabartë. Në shkollat e shteteve **e**uropiane**,** shumë e shumë nxënës me nevoja të veçanta shoqërohen nga mësues të specializuar në klasat e mësimit të rregullt. Në shkollat tona plotësimi i nevojave për këta nxënës prezanton sfida të veçanta për mësuesit. Planifikimi i mësuesit dhe mësimdhënia e tij, në përgjithësi përqëndrohen tek mësimi për të gjithë klasën dhe jo te mësimi i individualizuar.(Emmer & Evertson, 2018).

Sipas statistikave të fundit vihet re se rreth 13 % (6.4 milionë) e nxënësve të shkollave publike janë pjesë e shërbimeve të arsimit të veçantë. Kategoria e arsimit të veçantë me numrin më të madh të nxënësve karakterizohet nga pabarazia shëndetësore (12%), autizmi (7%), pabarazia në të folur (21%), pabarazia në shikim/ në të dëgjuar zë (1%) dhe së fundmi pjesën më të madhe të nxënësve e zënë nxënësit që kanë pabarazi në të mësuar. Ajo që duhet të themi është se ekziston një numër relativisht shumë i lartë i fëmijëve që kanë të drejtë të arsimohen prandaj, është shumë e rëndësishme që shkollat e të gjithë rajoneve të ndjekin rregulla specifike në mënyrë që nxënësve

që janë pjesë e këtyre kategorive t'iu ofrohet një arsim cilësor dhe i barabartë (Emmer & Evertson, 2018). Kërkimet tregojnë se janë pikërisht këta faktorë dhe shqetësimet e menaxhimit të klasës, që kufizojnë sasinë e vëmendjes që mësuesit i japin marrjes së njohurive për nxënësit në mënyrë individuale (Vaughn & Schumm, 1994). Për këto arsye është shumë e nevojshme të bëhen përpjekje të vetëdijshme nga mësuesit për të kuptuar dhe konsideruar nxënësit në mënyrë të barabartë dhe për t'iu dhënë më tepër mbështetje këtyre nxënësve.

Këta nxënës kanë më tepër nevojë për ndihmë se nxënësit e tjerë ndaj, mësuesit duhet të jenë mbështetës për to, ku nuk duhet të mungojnë lavdërimet pasi, lavdërimi është një ndër format më të bukura që mësuesi duhet të përdor, lavdërimi e motivon nxënësin. Nxënësit me aftësi të kufizuar kanë nevojë të jenë në kontakt me një mësues kryesor pasi mësuesi i ndihmon ato në elsplorimin e ndikimit social dhe emocional. Koha e kaluar me një person të rritur dhe të mësuarit e strategjive të përballjes me teknologjinë ndihmëse, krijon informacion dhe aftësi të rëndësishme (Emmer & Evertson).

III. Konkluzione

Ky studim u realizua me qëllim kryesor që të identifikoheshin metodat dhe strategjitë më efektive të cilat duhen ndjekur në mësimdhënie dhe mësimnxënie drejtuar nxënësve me aftësi ndryshe. Në këtë studim u pa nga afër roli i rëndësishëm që mbart mësuesi në integrimin, socializimin e kësaj kategorie nxënësish. Krijimi i aksesit për fëmijët me aftësi ndryshe në shkolla ka qenë dhe mbetet një problem shqetësues në vendin tonë ndaj, me anë të këtij studimi arritëm të nxirrnim në pah faktorë si: mungesa e kurrikulave dhe e mësuesve të trajnuar për këtë kategori nxënësish dhe mos përshtatja e ndërtesave. Këto elemente kanë ndikuar drejtpërdrejtë që një pjesë shumë e mirë e nxënësve me aftësi të ndryshe, të mos ndjekin shkollat normale.

Nga ky punim dolëm në konkluzionin se të gjitha institucionet arsimore të vendit tonë duhet të marrin karakteristikat e një shkolle që është gjithmonë në mbështetje të nxënësve me aftësi ndryshe pasi, shkollat që krijojnë kushtet për mësimdhënien kundrejt kësaj kategorie fëmijësh janë shkolla që u mundësojnë nxënësve me aftësi të veçanta të arrijnë potencialin e tyre të plotë në zhvillimin e aftësive të ndryshme emocionale dhe sociale. Qasja përfshirëse në arsim është shumë e rëndësishme për të vetmin fakt se ajo mbetet një qasje që gjithmonë bën përpjekje të promovojë cilësinë e orës mësimore. Me qëllim që të ecet drejt cilësisë në arsim, janë të nevojshme zbatimi i të gjitha strategjive që ne kemi parashtruar gjatë punimit tonë.

Si përfundim rezultoi se jo vetëm ekzistojnë mjaft pengesa që nuk i lejojnë nxënësit me aftësi ndryshe të kenë gjithmonë akses në orët mësimore por konstatohet dhe një përpjekje e ulët e mësuesve në motivimin, mbështetjen e këtyre nxënësve por edhe në parapërgatitjen për rolin dhe përgjegjësinë e tyre si edukatorë kundrejt nxënësve me aftësi ndryshe.

VI. Rekomandime

Nisur nga të dhënat e mësipërme u arrit në përfundimin se shkollat në vendin tonë nuk kanë arritur ende në stadin e të qenurit shkolla gjithëpërfshirëse. Përdorimi i strategjive, praktikave dhe metodave nga mësuesit kundrejt fëmijëve me aftësi të veçanta mbetet mjaft i ulët. Duke u bazuar në rezultatet që u gjetën në këtë studim do të fokusohem në dhënien e rekomandimeve në disa aspekte të rëndësishme të cilat, i pengojnë këta nxënës të kenë akses në zhvillimin e orëve mësimore;

• Shkollat nuk krijojnë një mjedis të përshtatshëm dhe motivues të nxënies

• Ato nuk kanë infastrukturën e nevojshme pra, ekzistojnë pengesa që nuk i lejojnë nxënësit me aftësi ndryshe të kenë akses në mësim

• Nuk përmbajnë në planin, dokumentet e tyre bazë, procedura për arsimimin e fëmijëve me aftësi ndryshe duke filluar nga momenti i regjistrimit të fëmijës në shkollë e deri në përshtatjen e plotë të tij. Me qëllim që të ecet drejt cilësisë në arsim është e domosdoshme që të gjitha nivelet e arsimit të priren drejt ndryshimeve.

Disa nga rekomandimet për ndryshimin e shkollave në mbështetje të nxënësve me aftësi ndryshe përmendim:

- Së pari, çdo shkollë duhet të ketë mësues të trajnuar posaçërisht për t'iu ardhur në ndihmë kësaj kategorie nxënësish. Shpesh herë ndodh që fëmijët me aftësi ndryshe të shfaqin sjellje agresive për shkak të trupës mësimore apo të mësuesve të cilët nuk janë të aftë për t'iu përshtatur mësimdhënies për këta nxënës.

- Së dyti, është shkolla ajo e cila duhet t'iu sigurojë nxënësve një infastrukturë të përshtatshme, pra duhet përshtatur mjedisi fizik duke eliminuar pengesat që ekzistojnë në ambientet shkollore.

- Së treti, përdorimi i materialeve konkrete, praktike dhe të mirë strukturuara teknologjike si: (korniza me shkrim/ makina diktimi) dhe aksesi në tekste të pangarkuara duhet të jetë një domosdoshmëri.

Një rekomandim të fundit e përbën organizimi i aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme. Organizimi i aktiviteteve është shumë i rëndësishëm pasi janë këto aktivitete me anë të të cilave nxënësit me aftësi ndryshe mësojnë dhe luajnë në role jo vetëm aftësitë e tyre personale por edhe ato shoqërore të cilat i kanë mësuar në situata të ndryshme.

V. Bibliografia

1. A. Bojaxhi, “Prindi, mësuesi më i parë dhe më jetëgjatë i femijës” Tiranë,2004

Emmer, Edmund T., et al. “Effective Classroom Management at the Beginning of the School Year.” *The Elementary School Journal*, vol. 80, no. 5, 1980, pp. 219–231. *JSTOR*, www.jstor.org/stable/1001461. Accessed 20 May 2021

2. Emmer, E., Evertson, C., & Anderson, L. (1980). Effective Classroom Management at the Beginning of the School Year. The Elementary School Journal, 80(5), 219-231. Retrieved May 20, 2021, from http://www.jstor.org/stable/1001461

3. L. Reçka,“Diversiteti dhe komunikimi në klasë”Gjirokaster,2016

4. Jackson, Shirley A., and Fred C. Lunenburg. “School Performance Indicators, Accountability Ratings, and Student Achievement.” American Secondary Education, vol. 39, no. 1, 2010, pp. 27–44. JSTOR, www.jstor.org/stable/41406181. Accessed 20 May 2021

5. O’Connor, Dennis. “Facilitating Learning and Leadership in Student Team Projects.” Learning from Each Other: Refining the Practice of Teaching in Higher Education, edited by Michele Lee Kozimor-King and Jeffrey Chin, 1st ed., University of California Press, Oakland, California, 2018, pp. 176–187. JSTOR, www.jstor.org/stable/10.1525/j.ctv3znxq0.17. Accessed 20 May 2021.

6. Sh. Haxhihyseni & A. Muho, “Hyrje në shkenca edukimi”, Durrës, 2017.

7. Sh. Bennett & D. Dwoert & K.Weber, “Special education in Ontario School”,2008.

8. Xh. Zekaj, “Metodologji e mësimdhënies dhe kurrikula në AMU”,Julvin 2,Tiranë,2018